



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E VITISË
OPSTINE VITINA
THE MUNICIPALITY OF VITI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E		REPUBLIKA KOSOVËS OPSTINA VITINA	
Titulli i Organizatës	Nr.	Org. broj	Nr.
02-016/01-1195			

Në bazë të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme komunale nr. 06/L-092, Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës komunale të Qeverisë së Kosovës, Vendimit të Kuvendit Komunal të Vitisë Nr. 01-110/05-541 të datës 30.06.2020 si dhe Vendimit 01-110/05-1051 të datës 29.10.2020 për ndryshimin e vendimit paraprak, për Inicimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale në qytetin e Vitisë, Komuna e Vitisë, me datën 11.11.2020 shpall:

NJOFTIM PUBLIK

*Për dhënie e pronës të paluajtshme të Komunës së Vitisë, në shfrytëzim 15 vjeçar,
Përmes*

ANKANDIT PUBLIK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS KOMUNALE ME DESTINIM KAFITERI

Nr.3/2020

NJOFTOHEN, të gjithë të interesuarit- personat juridik se Komuna e Vitisë, përmes procedurës së rregullt të ankandit publik me aprovimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Vitisë, do të jap në shfrytëzim afatshkurtër në kohëzgjatje prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh me destinim kafiteri.

NENI I : EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Komuna e Vitisë
Adresa : Rr 28 Nëntori, 61000 Viti
Personi kontaktus: Mifail Azizi
E-majli: Mifail.Q.Azizi@rks-gov.net
Telefoni :044402130

NENI II: LËNDA E SHITJES-ANKANDIT

Autoriteti kontraktues ka për qëllim dhënie në shfrytëzim 15 vjeçar të pronës komunale, në rrugën Adem Jashari, që është në anën e djathtë në hyrjen kryesore të ndërtesës së Shtëpisë së kulturës të Komunës së Vitisë, me sipërfaqe prej 72 m² ngastra kadastrale nr. **0-70101007-02591-0-20-5-1-0**. në zonën kadastrale Viti, me destinim kafiteri.

NENI III: INFORMATAT ADMINISTRATIVE

I: Kushtet e përcaktuara për pjesëmarrje në ankand- dokumentet e kërkuara:

1. Deklarata nën betim e Operatorit ekonomik të nënshkruar dhe vulosur, se përmbush kushtet e përshtatshmërisë
2. Çertifikatën e rexhistrimit të biznesit -kopje
3. Çertifikatën e numrit fiskal -kopje
4. Dëshmi se nuk obligime të pakryera ndaj komunës- origjinal
5. Dëshmi për obligimet e kryera ndaj ATK-së - **Vërtetimi i ATK-së** (vetëm për fituesin).
6. Dëshmi nga Gjykata ekonomike se nuk është i dënuar – **Vërtetimi i Gjykatës Ekonomike** (vetëm për fituesin)

II: Kriteret që kërkohen për fituesin janë: Oferta e përgjegjshme me çmimin më të lartë:

- Çmimi fillestar (minimal) i ofruar për muaj është 300.00 €
- Tërheqja e ofertave mund të bëhet në formë fizike dhe elektronike nga data 12.11.2020 Afati i fundit për tërheqjen e formularit të ofertave është deri me **23.11.2020**, Rr. 28 Nëntori, Zyra e prokurimit kati i 2, nr.24 të, Komuna e Vitisë.
- Afati i dorëzimit të ofertave në zarfa të mbyllur të protokoluar (një origjinal dhe një kopje) me **25/11/2020** deri në ora **13.30**, Zyra e prokurimit, Komuna e Vitisë.
- Hapja e ofertave bëhet me **25.11.2020** në ora **14.00** në Zyren e prokurimit, nr.24.
- Hapjen dhe vlerësimin e ofertave e ben komisioni i emëruar i Kuvendit të komunes të Vitisë në prani të përfaqësuesve të interesuar të kompanive që kanë ofertuar
- Operatorët ekonomik të paknaqur me procesin e vlerësimit kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve në Komisionin Komunal për ankese për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale i themeluar nga Kuvendi Komunal

Ky njoftim shpallet në shpalljet e komunës, në mjetet lokale të informimit publik dhe në Web faqen e Komunës së Vitisë.

I dorëzohet:

- Komisionit të Ankandit
- Kryesuesit të Kuvendit Komunal
- Zyrës për informim
- Arkivit



Kryesuesi i Komisionit:
Mifail Azizi